



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

PSE

TË STUDIONI NË
FAKULTETIN
E FILOLOGJISË



SCAN MF





UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

Pse duhet të studioni në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”?

- UP-ja ka rangimin më të lartë nga të gjitha universitetet në trevat shqiptare.
- Fakulteti i Filologjisë i UP-së ka traditë më të gjatë në Kosovë në studimet universitare.
- Fakulteti i Filologjisë e ka stafin akademik më të kualifikuar në Kosovë.
- Së paku një semestër gjatë studimeve në Fakultetin e Filologjisë mund të realizohet në universitetet më të njohura evropiane (Berlin, Venecie, Romë, Freiburg, Pragë, Torunj, Vechta, Kopenhagë, Poznanj, Stamboll, Edirne, Sofje, Zagreb, etj.).
- Studimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” janë pa pagesë.
- Diplomë që njihet ndërkombëtarisht.
- Marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione evropiane dhe rajonale.
- Programe atraktive me gjasa të larta për punësim.



Departamenti i Gjuhës Shqipe

Në Departamentin e Gjuhës Shqipe ofrohen studime për gjuhën shqipe, për varietetin standard të shqipes dhe varietetet e tjera dialektore. Studimi në Departamentin e Gjuhës Shqipe është mjaft i rëndësishëm, ngase studentët do të kenë mundësi t'i zgjerojnë dhe t'i thellojnë njohuritë e tyre në gjuhësinë teorike, sistemin e shqipes, strukturën e saj, si në planin sinkronik, ashtu edhe në planin diakronik. Po ashtu, studentët njihen edhe me konceptet dhe parimet e fushave të gjuhësisë aplikative, të cilat, në njërin anë, i aftësojnë studentët të kryejnë hulumtime shkencore gjuhësore të pavarura, ndërsa, në anën tjetër, u ndihmojnë edhe në zhvillimin e shkathtësive të tyre si mësimdhënës.




Pra, i aftësojnë ata në mësimdhënien e gjuhës shqipe, qoftë si gjuhë e parë, apo si gjuhë e dytë. Rrjedhimisht, studentët e Departamentit të Gjuhës Shqipe, pasi t'i përfundojnë studimet orientohen në mësimdhënie në institucionet arsimore në vend, por edhe në fushën e redaktimit e të lekturimit në medie e shtëpi botuese në vend. Departamenti i Gjuhës Shqipe ka marrëveshje bashkëpunimi me universitete të ndryshme në botë, e posaçërisht me qendrat e Albanologjisë. Falë këtij bashkëpunimi, shumë studentë të Departamentit kanë arritur që, nëpërmjet programeve të ndryshme, siç janë ERASMUS + dhe Mewlana Exchange Programme, disa semestra t'i kalojnë nëpër universitete të ndryshme, si: në Gjermani, Çeki, Poloni, Itali etj. raktive me gjasa të larta për punësim.

Departamenti i Letërsisë Shqipe

Studimi i letërsisë shqipe përbrenda Departamentit me të njëjtin emër në kuadër të Fakultetit të Filologjisë është një nga shtyllat themelore të studimeve humanitare e filologjike në Universitetin e Prishtinës. Katedra e Albanologjisë në Prishtinë është themeluar madje para se të themelohej Universiteti i Prishtinës (1960).

Qëllimi themelor gjithnjë ka qenë, është dhe do të jetë avancimi i studimeve në fushë të letërsisë. Po kështu, avancimi i kualifikimit të mësimeve të rinj, të cilët pastaj marrin barrën e transmetimit të dijeve në shkollat e nivelit parauniversitar,





duke qenë se ata kryesisht punësohen në shkollat si mësimdhënës të lëndës Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

- Departamenti i Letërsisë Shqipe ofron studime nga fushat e ndryshme të Letërsisë në përgjithësi dhe të Letërsisë Shqipe në veçanti. Studimet ofrohen në tri nivele:

1. Bachelor (BA)
2. Master (MA)
3. Doktoraturë (PhD)

Fushat studimore që ofrohen gjatë studimeve janë: Historia e letërsisë shqipe, Teoria e letërsisë, Kritika letrare, Letërsia botërore, Letërsia e krahasuar, si dhe lëndë të ndryshme bazike nga gjuhësia.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane

Njohja e gjuhës gjermane lehtëson punësimin tuaj në tregun e punës në Kosovë. Anketat e fundit tregojnë se 100% e të diplomuarve nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane janë të punësuar. Studimet në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane janë një mundësi për t'i plotësuar njohuritë tuaja gjuhësore me kompetencë në aspektin teorik e praktik në fushat si gjuhësia e letërsia gjermane, përkthimi gjermanisht-shqip dhe mësimdhënia e gjermanishtes si gjuhë e huaj. Gjatë studimit do të keni edhe mësimdhënës nga Gjermania dhe Austria, të cilët në kuadër të lektorateve të DAAD dhe OEAD organizojnë edhe shumë aktivitete ekstrakurrikulare kulturore, si dhe informojnë për programet e bursave për studime në universitetet e Gjermanisë dhe të Austrisë. Po ashtu përmes marrëveshjeve të shumta ERASMUS+ do të keni mundësinë që ta përfundoni një semestër të studimeve tuaja në vendet e BE-së.

Deutsche Sprache



Departamenti i Gazetarisë

Roli i gazetarit asnjëherë nuk ka qenë më i rëndësishëm se sot, kur po jetojmë në epokën e pas të vërtetës dhe qarkullimit të madh të dezinformatave. Për t'i ndjekur mësimet e duhura dhe për ta marrë rrugën e duhur në profesionin e gazetarit, adresa e duhur është Departamenti i Gazetarisë në UP. Programi i Gazetarisë në UP ofron mundësitë për përgatitje të nevojshme që të bëheni pjesë e tregut medial në vendin tonë. Krahas aftësimit në raportim, intervista e gjykim kritik, programi ju mundëson të fitoni njohuri të reja në fushën audiovizuale, në krijimin e audiove, videove e kështu me radhë. Të gjitha këto arrihen, sepse në programin e Gazetarisë në UP do të mësoni aspektet teorike dhe praktike të gazetarisë, duke shfrytëzuar edhe MediaLab-in, që është një studio televizive, si dhe RadioUP-në, e cila ofron kushtet optimale për radiogazetarinë. Gjithashtu, stafi akademik, me përvojë të gjatë në fushën akademike, por edhe atë profesionale, ju ofron pikërisht atë që ju duhet për nesër, në mbulimin e ngjarjeve kryesore në vend nga ju, që jeni e ardhmja e gazetarisë në vendin tonë



Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë angleze me një përvojë mbi gjashtë dekada, me një bazë të mirëfilltë akademike përmes programeve të qëndrueshme dhe të akredituara të studimit ka dëshmuar në vazhdimësi angazhimin për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie duke fituar kështu besueshmërinë nga masa e gjerë e popullatës. Qasja bashkëkohore interaktive me studentin në qendër vjen si rezultat i performancës dhe kompetencës së shkëlqyeshme të mësimdhënësve të aftësuar e trajnuar profesionalisht në nivelin lokal, rajonal e ndërkombëtar, si në Cambridge, Oxford, Maryland etj. Këtë po ashtu e mundësojnë dhomat e mësimimit, laboratori i gjuhës, biblioteka dhe hapësirat e tjera të renovuara së fundi të pajisura me teknologjitë dhe pajisjet moderne për një mësimdhënie sa më cilësore.

point
Englis
langu

Orientimi hulumtues, shkencor, profesional për studentët ofrohet përmes projekteve e seminareve të shumta në kuadër të kurseve mësimore, konferencës vjetore të studentëve, si dhe konferencës së KETNET-it që organizohen nga kjo degë.

Gjuha angleze është një nga gjuhët më të folura në botë si dhe gjuhë ndërkombëtare e komunikimit të biznesit. Po ashtu veprat më të mëdha letrare janë shkruar në anglisht. Përveç kësaj, gjuha angleze është gjuhë e internetit dhe turizmit dhe përmes saj do të keni qasje në informacionin objektiv, në platforma e revista online. Mbi të gjitha, përvetësimi i gjuhës angleze paraqet një avantazh me rëndësi në tregun e punës. Ofrimi me tregun e punës për studentët mundësohet edhe përmes bashkëpunimit me Ambasadën e SHBA-së, Këshillit Britanik si dhe institucioneve publike dhe private në Republikën e Kosovës, në përfaqësitë diplomatike të Kosovës dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare qeveritare apo joqeveritare në Kosovë.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Frënge

Ky program është konceptuar me lëndë që e mundësojnë kualifikimin dhe formimin në fushat, si: letërsi, gjuhë, metodikë/didaktikë me qëllim të përvetësimit të kompetencave teorike në bashkëpunim me shkollat e mesme, ku edhe realizohet formimi praktik i mësimeve të rinj. Me këtë program studentët, gjithashtu, e përvetësojnë kulturën e mahnitshme franceze, historinë, traditën, artin, muzikën, kinematografinë dhe gastronominë. Siç e dimë, Franca ka një pozitë të lartë në Bashkimin Evropian, sepse është vetë ajo që e krijoi. Frëngjishtja ka argumente mjaftueshëm për ta bërë të ditur tek i tërë njerëzimi se është gjuhë me peshë cilësore e ndërkombëtare; flitet në të gjitha kontinentet dhe njihet në tërë botën. Përveç se është gjuhë e shumë organizatave botërore (siç janë Organizata e Kombeve të



Bashkuara, e UNESCO-s, e NATO-s, e Komitetit Ndërkombëtar Olimpik, e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe përgjegjëse e shumë çështjeve gjyqësore, politike, ekonomike e juridike ndërkombëtare), frëngjishtja është edhe gjuhë e punës. Frëngjishtja i takon një shteti me ekonomi të lartë, pozitë gjeografike botërisht të lakmueshme dhe letërsi artistike e filozofike; ta mësoni këtë gjuhë, së pari, ju bën të ndiheni artistë falë tingullit kumbues që ka, dhe së dyti, kjo gjuhë ju sjell vetëm avantazhe, epërsi në karrierën tuaj studimore. Kurset ofrojnë një program bashkëkohor, sipas kriterëve të parapara nga BE-ja, një mësimdhënie kreative dhe interaktive, me një teknologji të sofistikuar, duke përdorur platforma të ndryshme digjitale dhe teknikat më bashkëkohore didaktike. Programi BA, gjithashtu, ofron aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me Ambasadën e Francës, Aleancën Franceze, AUF-in, Qendrën Kulturore Frankofone, Qendrën e Gjuhëve të Huaja në Fakultetin e Filologjisë etj. Dega Gjuhë dhe Letërsi Frënge ka dhjetëra marrëveshje ERASMUS + të nënshkruara me universitete të njohura evropiane për shkëmbim të studentëve dhe stafit akademik.



Departamenti i Orientalistikës

Departamenti i Orientalistikës është themeluar në vitin 1973, duke u bazuar në njohjen dhe studimin e trashëgimisë orientale në rajonin e Ballkanit dhe sidomos ato shqiptare, si dhe në ndërveprimet aktuale të komunitetit tonë me botën e Lindjes. Në Departamentin e Orientalistikës mësohen dhe studiohen gjuhët orientale, si: turqishtja, arabishtja dhe persishtja. Përveç këtyre gjuhëve, në këtë departament studiohen edhe letërsitë orientale dhe poetët më të mëdhenj të këtyre letërsive. Rëndësia e studimit në orientalistikë qëndron në atë se studentët që i përfundojnë studimet në këtë departament





kanë mundësi të njihen me gjuhët dhe kulturat e popujve të Orientit, të mësojnë për trashëgiminë kulturore orientale në Ballkan dhe rajonet shqiptare, si dhe do të jenë të pajisur me dije dhe njohuri për interpretimin e shumë fenomeneve kulturore e politike që ndërlidhen me Orientin. Departamenti i Orientalistikës është themeluar për nevojat e tregut të punës në Kosovë dhe ofron shumë mundësi punësimi: si mësimdhënës, përkthyes, hulumtues shkencorë, redaktor, zyrtar në konsullatat, zyrtar ndërlidhëse, në ambasadat dhe organizatat e shteteve të orientit në Kosovë dhe më gjërë.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke i themeluar më 1988 deri më tani ka ofruar studime të nivelit BA, por edhe gjatë periudhës 2005-2008 dhe 2019-2021, ka pranuar gjithsej pesë gjenerata në studime MA. Programin Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Turke, është t'i përgatisë studentët me dituritë themelore nga teoria gjuhësore dhe metodologjia, si dhe t'i aftësojë ata për zbatimin e teorisë në mësimin praktik. Nga ana tjetër, ky program mësimor synon edhe mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë. Si njësi bazë mësimore-kërkimore



Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke zhvillon, administron dhe bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fushën e Gjuhës dhe Letërsisë Turke. Programi BA i Gjuhës dhe Letërsisë Turke është hartuar nisur nga nevojat e tregut të punës në Kosovë, i cili ofron disa mundësi punësimi: si mësimdhënës, përkthyes, nëpunës në administratë, etj. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke i cili vepron në kuadër të Fakultetit të Filologjisë e ka hartuar këtë program të konceptuar si kualifikim themelor në gjuhësi dhe letërsi turke, i plotësuar me lëndë që mundësojnë kualifikimin në fushën e metodikës dhe të didaktikës së gjuhës turke si gjuhë amtare dhe e huaj, pasi një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve të Gjuhës dhe të Letërsisë Turke punojnë në institucione arsimore (universitete, shkolla publike dhe private, kurse të gjuhës turke).



Programi Ballkanistikë

I tërë procesi mësimor brenda këtij programi është dinamik, i orientuar drejt kërkimit/hulumtimit dhe i përshtatur për nevoja praktike. Studimet në këtë program fokusohen në mësimin e gjuhës shqipe paralelisht me një gjuhë tjetër ballkanike. Ekziston një kërkesë e madhe në tregun e punës për përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhë të komuniteteve të tjera dhe anasjelltas. Sipas hulumtimeve të fundit tregu kosovar tashmë ka mungesë për profesionistë të gjuhëve zyrtare dhe brenda 5-10 viteve të ardhshme do të ketë nevojë për më tepër se 200 përkthyes. Programi u përgjigjet standardeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Programi është në përputhje me kodet përkatëse të Erasmus Subject Area Codes (ESAC).



Programi ofron kurrikula të ngjashme me ato të rajonit. Programi ofron ligjërata nga profesorë vizitorë nga universitetet evropiane dhe të Ballkanit që ofrojnë programe të ngjashme, në kuadër të shkëmbimit akademik Erasmus +. Programi ofron kurse përgatitore për studentë drejt arritjes së nivelit të duhur në kuadër të Qendrës së Gjuhëve brenda Fakultetit të Filologjisë. Programi aftëson studentët në 3 fusha: mësimdhënie, përkthim/interpretim dhe hulumtim.

Programi ofron mundësi studimi në një program të dyfishtë (double-major), mësimin e gjuhës shqipe paralelisht me një gjuhë tjetër ballkanike, mësimin e 4 gjuhëve: 3 gjuhë ballkanike (shqipe, boshnjake/serbe/kroate/maqedonase, bullgare, greke) + 1 gjuhë të huaj (angleze, gjermane, frënge, spanjolle, italiane) ,



mundësi studimi me bursa Erasmus + në universitete të BE-së, studimin e veçorive gjuhësore dhe kulturore të Ballkanit, gjuhët dhe dialektet, letërsinë dhe folklorin, trashëgiminë kulturore dhe historinë e përbashkët të Ballkanit. Me përfundimin e këtij programi studentët do të kualifikohen për: mësimdhënës të gjuhëve ballkanike (shqip dhe një gjuhë tjetër ballkanike), përkthyes dhe interpretë për dy ose më shumë gjuhë, këshilltarë për çështje të Ballkanit në organizata qeveritare dhe joqeveritare, ekspert për sektorin publik të komunikimeve rajonale, ekspert i çështjeve kulturore dhe historike të Ballkanit, hulumtues shkencorë. Gjithashtu, mund të vazhdojnë studimet në universitete partner, vazhdojnë studimet në programin Master profesional për përkthim/interpretim, aplikojnë për t'u licencuar si përkthyes gjyqësor





UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

<https://filologjia.uni-pr.edu>



SCAN ME